

Nis Censi i Popullsisë dhe Banesave 2023

Tiranë, më 18 Shtator 2023: Sot ka nisur zyrtarisht Censi i Popullsisë dhe Banesave 2023.

Data 18 shtator konsiderohet dita e Censit të Popullsisë dhe banesave në Shqipëri.

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë punonjësit e INSTAT, anketues, kontrollorë, mbikqyrës kanë dalë në terren për të numëruar popullsinë rezidente në Shqipëri dhe kushtet e tyre të banesës.

Ky është një proces statistikor, por me përmasa të mëdha dhe të një rëndësie të vecantë për vendin.

Deri tani, referuar sistemit të monitorimit, si dhe nga përfaqësuesit e INSTAT në terren procesi po shkon mirë. Janë regjistruar në aplikacion pjesa më e madhe e anketuesve (85 %); janë në proces intervistimi rreth 1.500 intervista prej të cilave janë përfunduar rreth 800 pyetësorë.

Procesi është dinamik dhe po shkon sipas pritshmërive. Intervistat do të vazhdojnë edhe pasdite për të mundësuar kontaktimin me qytetarët të cilët gjatë paradites kanë qenë të angazhuar me punë.

Duhet të theksojmë se ky aktivitet do të zgjasë 6 javë, INSTAT në mënyrë të vazhdueshme do të japë informacion mbi ecurinë e këtij aktiviteti.

Të dhënat e grumbulluara më pas do të përpunohen për prodhimin e statistikave zyrtare të rëndësishme për:

- Hartimin e politikave dhe vendimmarrjeve bazuar në shifra, nivel qendror dhe lokal;
- Lehtësimimin në planifikim për ndërtim kopshte, shkolla, spitale, parqe, etj;
- Lehtësimin në vendimmarrje nga komuniteti i biznesit
- Konceptimin dhe krijimin e regjistrave statistikorë të popullsisë rezidente, ndërtesave dhe banesave.

Ftojme çdo individ rezident në Shqipëri t'i kushtojë disa minuta procesit të numërimit, duke bashkëpunuar me anketuesit të cilët ndodhen në terren, pasi Censi është një e mirë publike në interes të çdo qytetari.

Ju faleminderit!

Për publikim 18/09/2023